



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 shtator 2017
Nr. ref.:RK1124/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI116/16

Parashtrues

Asrije Muçolli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 68/2016, të 19 prillit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Asrije Muçolli (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës) nga Podujeva.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 68/2016, të 19 prillit 2016 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2017/2015, të 21 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 2934/11, të 27 shkurtit 2015.
3. Parashtruesja e kërkesës ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme më 8 qershor 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 68/2016, të 19 prillit 2016.
5. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) si dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 22 shtator 2016, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 19 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 29 nëntor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga parashtruesja dorëzimin e dëshmisë (fletëkthesës) që tregon ditën pranimit të vendimit të kontestuar.
10. Më 6 dhjetor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që tregon se parashtruesja e kërkesës kishte pranuar vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 8 qershor 2016.
11. Më 3 korrik 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 9 dhjetor 2003, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KEK), me Vendimin nr. 5594, përcaktoi se parashtrueses së kërkesës i njihet e drejta për kompensim të mjekimit në botën e jashtme për shkak të lëndimit trupor në vendin e punës.
13. Më 17 dhjetor 2003, KEK-u me 'letër-urgjencë' kërkoi nga Zyra Gjermane në Kosovë që parashtrueses së kërkesës t'ia mundësonte dhënien e vizës për në Gjermani, për shkak të trajtimit mjekësor, meqenëse ajo ishte lënduar në vendin e punës.
14. Më 7 korrik 2005, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur padi kundër KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit nga marrëdhënia e punës. Parashtruesja atëbotë kishte kërkuar, mes tjerash, kompensim në vlerë prej 69.000 euro për shkak të dhimbjeve fizike e psikike, zvogëlimit të aktivitetit jetësor, zvogëlim i aftësisë punuese-invaliditeti, shëmtimi trupor dhe shpenzimet e mjekimit. Parashtruesja po ashtu kishte bashkëngjitur prova të konstatimit të gjendjes së saj shëndetësore nga ekspertët mjekësor.
15. Më 19 korrik 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C1. nr. 230/2005 pjesërisht aprovoi padinë e parashtrueses dhe detyroi të paditurën KEK që, mes tjerash, në emër të dhimbjeve fizike e shpirtërore, zvogëlimit të aktivitetit jetësor, zvogëlimit të aftësisë punuese-invaliditeti dhe shëmtimit trupor t'ia kompensoj parashtrueses shumën e caktuar në euro në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit.
16. Gjykata Komunale, ndër të tjera, konstatoi se ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se parashtruesja ishte lënduar në vendin e punës dhe se ky konstatim po ashtu mbështetej me dokumentet e nxjerra nga vetë KEK-u dhe ekspertët e mjekësisë. Gjykata Komunale, mes tjerash, po ashtu shtoi se KEK-u nuk kishte marrë masat e duhura për mbrojtje të parashtrueses në vendin e punës dhe se bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe të drejtën objektive ishte përgjegjës për lëndimin e saj në vendin e punës.
17. KEK-u paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ose priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.
18. Më 11 mars 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin Ac. nr. 771/2008 përcaktoi:

"I.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e palës së paditur Korporata Energjetike e Kosovës, në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C1. nr. 230/05, të datës 19.07.2007, në paragrafin I në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit për dhimbje fizike në shumë prej 7000 €; për zvogëlim të aktivitetit jetësor, në shumë prej 15.000 €; për shëmtim trupor në shumë prej 14.000 € si dhe në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj, në shumë prej 200 €; dhe në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 300 €, me kamatë ligjore, të cilat

banka i paguan në mjete të afatizuara për një vit, duke filluar prej ditës së ekspertizës mjekësore me 20.12.2006 e deri në pagesën definitive si dhe paragrafi III. i cili ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore 1.366,00 €. VËRTETOHET.

II.PJESËRISHT aprovohet ankesa, e të paditurës dhe aktgjykimi ankimor në paragrafin I, të dispozitivit në pjesën i cili ka të bëjë me kompensimin e dëmit për dhimbje shpirtërore në shumë prej 7.000 € si dhe zvogëlim të aftësisë punuese-invaliditetit, në shumë prej 15.000 €. PRISHET dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

I njëjti aktgjykim në paragrafin II të dispozitivit mbetet i pandryshuar”.

19. Ndërkohë, KEK-u paraqiti kërkesë për revizion kundër aktgjykimit të lartpërmendur në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të ndryshohen të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe kërkesëpadia e parashtrueses të refuzohet e pabazuar.
20. Më 8 nëntor 2011, Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr. 289/2009 pranoi të bazuar revizionin e KEK-ut, prishi aktgjykimet e gjykatave të instancës së ulët dhe çështjen e ktheu në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Gjykata Supreme arsyetoi, mes tjerash, se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale dhe se nuk ishte vërtetuar nëse parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar masa mbrojtëse në vendin e punës; dhe se a ka qenë e domosdoshme, që KEK-u t'i sigurojë asaj pajisjet e nevojshme për mbrojtje në punë.
21. Më 1 janar 2013, kishte filluar zbatimi i Ligjit për gjykata (Nr. 03/L-199) që përcaktonte: “Neni 2.1.1.2 Gjykata Themelore - gjykatë e shkallës së parë, me seli në shtatë qendra rajonale gjeografike të themeluara me këtë ligj; Neni 17.1 Gjykata e Apelit themelohet si gjykatë e shkallës së dytë, me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës”.
22. Më 27 shkurt 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin C. nr. 2934/11, e refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës që në emër të dëmit material dhe jomaterial t'i kompensohet shuma prej 69.000 euro. Gjykata Themelore kishte administruar provat e ofruara nga ekspertët mjekësorë dhe kishte dëgjuar tre dëshmitarë përkitazi me lëndimin e parashtrueses në vendin e punës.
23. Më 10 prill 2015, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesja, mes tjerash, u ankua se Gjykata Themelore nuk kishte dhënë arsyetim të duhur dhe bindës se përse nuk ka pranuar deklaratimet e dëshmitarëve se ajo është lënduar në vendin e punës, duke u mbështetur në arsyetimin absurd se nuk është përpiluar procesverbal apo fletëparaqitje e fatkeqësisë në punë.

24. Më 21 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ac. nr. 2017/2015, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, mes tjerash, konstatoi se parashtruesja nuk ka arritur që me prova konkrete ta vërtetojë se është lënduar në vendin e punës.
25. Më 3 shkurt 2016, parashtruesja paraqiti kërkesë për revizion kundër aktgjykimeve të gjykatave themelore dhe të apelit në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesja e kërkesës theksoi se: (i) gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës Supreme, sepse nuk kanë vërtetuar faktin nëse KEK-u, si punëdhënës, kishte obligim për të siguruar mjetet mbrojtëse në punë, (ii) gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë arsyetuar se përse nuk ishin të besueshme deklaratat e dëshmitarëve që tregonin se parashtruesja ishte lënduar në vendin e punës dhe, se (iii) lëndimi në punë nuk argumentohet vetëm me fletëparaqitje të fatkeqësisë në punë, porse kjo mund të vërtetohet edhe me dëshmitarët që kanë dijeni dhe që kanë treguar se parashtruesja është lënduar në vendin e punës.
26. Më 19 prill 2016, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 68/2016, refuzoi të pabazuar revizionin e parashtrueses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme, mes tjerash, arsyetoi se (i) gjykatat e instancës më të ulët kanë arsyetuar se përse nuk kanë marrë për bazë deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar, (ii) në bazë të provave të administruara nuk është vërtetuar se parashtruesja ishte lënduar në vendin e punës dhe (iii) pasi që nuk është vërtetuar se paditësja është lënduar në vendin e punës, atëherë, nuk ka nevojë të vërtetohet fakti nëse e paditura KEK ka siguruar mjetet e mbrojtjes në punë.
27. Pjesa relevante e aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, përcakton:

“Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, në këtë çështje juridike në mënyrë të drejtë është aplikuar e drejta materiale, kur është konstatuar se aksidenti ka ndodhur me 04.11.2002, fletëparaqitja origjinale e fatkeqësisë në punë nuk ekziston në shërbimin profesional të paditurës, dhe në dosjen shëndetësore të paditëses në entin shëndetësor të KEK-ut, rezulton se paditësja është lënduar në mars të vitit 2003, ndërsa është lajmëruar në Entin Shëndetësor të KEK-ut 6 muaj pas lëndimit. Në bazë të raportit me shkrim të ekspertit Dr. ing. Hamit Nuredini është konstatuar se paditësja nuk është lënduar në punë.

Për të ekzistuar detyrimi i shpërblimit të dëmit, duhet të plotësohen 4 parakushte: 1. të ekzistojnë subjektet e marrëdhënies detyrimore dhe përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, shkaktuesi i dëmit dhe i dëmtuari, 2. të ekzistojë fakti dëmtues nga rrjedh dëmi, 3. të ekzistojë dëmi i shkaktuar, 4. të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet veprimit dhe dëmit të shkaktuar, 5. të ekzistojë kundërligjshmëria e veprimit përkatësisht të mosveprimit nga është shkaktuar dëmi. Në rastin konkret nuk është vërtetuar se lëndimi a i është shkaktuar në vendin e punës, për çka do të ishte përgjegjëse e paditura.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të dhëna në aktvendimin e saj Rev.nr.289/2009 të datës 08.11.2011, se e paditura a ka siguruar mjetet e mbrojtjes në punë, nga arsyeja se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se paditësja ka pësuar lëndime në vendin e punës dhe nuk është e nevojshme të vërtetohet fakti se e paditura a ka siguruar mjetet e mbrojtjes në punë. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar faktin se nuk ka marrë për bazë deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar, nga se ato nuk janë të besueshme për të vërtetuar faktin se paditësja a ka pësuar lëndime në vendin e punës, prandaj edhe thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar në vendosjen në këtë çështje juridike nuk qëndrojnë”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
29. Parashtruesja e kërkesës pretendon: “*në aktgjykimin e dt. 19.07.2007 shihet qartë se e paditura nuk e ka kontestuar lëndimin tim në vendin e punës si dhe e ka pranuar edhe fletëlëndimin me., nr. protok. 547 të dt. 08.05.2003, por i ka kontestuar llojet e dëmtimeve dhe shumat e kërkuara nga paditësja, dhe gjykata me Aktgjykim Cl. nr. 230/2005 të dt. 19.07.2007 ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, i cili aktgjykim pjesërisht është vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë AC. nr. 77112008 të dt. 11.03.2009 duke e prishur vetëm pjesën sa i përket pjesës së gjykuar për dhembje shpirtërore dhe zvogëlim të aftësisë punuese”.*
30. Parashtruesja e kërkesës pretendon: “*Gjykata në Aktgjykimin C.nr.2934/2011 te dt. 27.02.2015 nuk ka marrë parasysht vizitat te mjeku në Shtëpinë e Shëndetit në Podujevë, dëshmitë e dëshmitarëve që kanë qenë prezent në momentin kur kam pësuar lëndim, si dhe fletëlëndimin me nr. 547 i protokolluar me dt. 08.05.2003, i cili është lëshuar dhe nënshkruar nga mbikëqyrësi gjegjësisht Drejtori Musa Jusufi me dt. 10.11.2002”.*
31. Parashtruesja e kërkesës pretendon: “*Përfaqësuesi i KEK-ut Osë Kuqi i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt. 23.12.2014 kishte cekur se ekziston dyshimi i bazuar se paditësja është lënduar jashtë vendit të punës, me këtë deklaratë të përfaqësuesit të të paditurës shihet se çfarë tretmani kanë punëtorët të cilët pësojnë lëndime në vendin e tyre në punë në KEK gjegjësisht në Elektro-Kosovë, sepse Osë Kuqi ka qenë qysh në fillim në dajeni për lëndimin tim në vendin e punës si dhe ka qenë i autorizuar nga KEK-u që të shkoj pranë zyrës Gjermane në Prishtinë, të bëjë urgjencë që sa më shpejt të jetë e mundur të ma lëshojnë vizën gjermane ku shihet në autorizimin me nr. protokollit 5882 i dt. 19.12.2003”.*
32. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kanë nxjerrë vendime të paarsyetuara: “*Gjykata e Apelit përpos që nuk i ka arsyetuar vendimet/konkluzionet e saj, madje as nuk i ka përsëritur*

arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë - dhe nuk e arsyeton se pse pajtohet me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë...Gjykata Supreme e Kosovës ka përsëritur heshtazi të gjitha shkeljet e instancave paraprake, duke i kthyer ato në shkelje të vazhdueshme të lirive dhe të drejtave themelore nga pushteti gjyqësor i shtetit. Gjykata, ndër të tjera, nuk i arsyeton fare vendimet e saj se nuk ka pasur shkelje të drejtës formale dhe se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale”.

33. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 2934/2011, të 27 shkurtit 2015, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2017/2015, të 21 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 68/2016, të 19 prillit 2016 dhe që kërkesa të kthehet për rigjykim në mënyrë që asaj t'i jepet mundësia për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse parashtruesja kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Gjykata iu referohet neneve 48 dhe 49 të Ligjit, që parashohin:

Neni 48 Saktësimi i kërkesës

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 Afatet

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”.

37. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 (2) d) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

38. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar për të dorëzuar kërkesën, ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës si dhe kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit.
39. Gjykata po ashtu duhet të vërtetojë nëse parashtruesja e kërkesës ka arritur që kërkesën e saj ta saktësoj dhe të mbështes pretendimet e ngritura në pajtim me nenin 48 të Ligjit.
40. Parashtruesja e kërkesës, në thelb, pretendon se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh provat e parashtruara nga ajo për të konstatuar se ajo është lënduar në vendin e punës dhe për të përcaktuar obligimin KEK-ut, si punëdhënës, që t'ia kompensojë asaj dëmet materiale dhe jomateriale që i kishte pësuar kur ishte lënduar në vendin e punës.
41. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e standardeve kushtetuese gjatë proceseve gjyqësore në gjykatat e rregullta, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu mutatis mutandis shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012 dhe rastin nr. KI86/16, parashtrues i kërkesës, “*BENI*” *Ndërmarrje Tregtare*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2016).
42. Gjykata thekson se detyrë e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
43. Gjykata po ashtu thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç nëse kjo mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
44. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, mutatis mutandis, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
45. Sa i përket pretendimeve të pranueshmërisë së provave, Gjykata konsideron se, edhe pse neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës garantojnë të drejtën për një gjykim të drejtë, ato nuk përcaktojnë ndonjë rregull mbi pranueshmërinë e provave të tilla, të cilat, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë, janë kryesisht çështje të ligjshmërisë. Në veçanti, nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit të kryera nga gjykatat e rregullta, përveç, dhe për aq sa, ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta. (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI114/15, Parashtruese *Feride Aliu-Shala*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të

Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 95/2015, të 12 majit 2015, Aktvendim për papranueshmëri i 17 majit 2016, paragrafi 39 me referenca tjera).

46. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtrueses i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ajo kishte mundësi që, gjatë fazave të ndryshme të procedurës, të nxjerrë argumente dhe dëshmi që ajo i konsideroi relevante për rastin e saj; se asaj i është dhënë mundësia që të kontestoj në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të saj janë dëgjuar e shqyrtuar nga gjykatat e rregullta; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimit të goditur ishin shtruar hollësisht. Rrjedhimisht, rezulton se procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (Shih, për shembull, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], aplikacioni nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
47. Nuk është detyrë e Gjykatës që të spekulojë nëse dëshmitë e dëshmitarëve të ftuar nga parashtruesja e kërkesës janë provë më e fortë në krahasim me provat e ofruara nga pala kundërshtare dhe konkluzionet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Nuk ka ndonjë element që do ta bindte Gjykatën për të përfunduar se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare ose të paarsyeshme gjatë përcaktimit të fakteve ose interpretimit të së drejtës vendore (shih rastin *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, GJEDNJ, aplikacioni nr. 20134/05, Aktgjykim i 7 shkurtit 2012, paragrafi 176).
48. Në këtë drejtim, duhet pasur parasysh, sepse ky është burimi i shumë keqkuptimeve nga ana e parashtruesve të kërkesave, që “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi “substanciale” (koncept që është pjesërisht ligjor, e pjesërisht etik dhe që mund të zbatohet vetëm nga gjyqtari i faktit), por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, kjo shprehet me procedurë kontradiktore ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI42/16 parashtrues *Valdet Sutaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 201/2015, të 8 shtatorit 2015, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura në atë vendim).
49. Neni 31 i Kushtetutës nuk garanton rezultat të favorshëm në rastin e parashtruesve, dhe as nuk lejon që Gjykata ta vë në pikëpyetje drejtësinë materiale të rezultatit të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 231/2015, të 1 shtatorit 2015, Aktvendim për papranueshmëri i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
50. Fakti se parashtruesja e kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentuar për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (Shih, për shembull, rastin nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim mbi papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).
51. Në këto rrethana, Gjykata konsideron që parashtruesja e kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e saj për shkelje të të drejtave themelore të njeriut siç

garantohen me Kushtetutë dhe me Konventë. Faktet e rastit nuk tregojnë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me Kushtetutë dhe Konventë.

52. Rrjedhimisht, kërkesa, në baza kushtetuese, është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi